



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:155226

Datë: 02.08.2022

Numri i dokumentit: 03291400

PKR.nr.142/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas kryetares së trupit gjykues Nushe Kuka Mekaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Zelfije Prekaj, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit H.M, *për shkak të veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-së*, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.211/2022 të dt. 01.08.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik të dt.02.08.2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Agron Galani, të pandehurit dhe mbrojtëses së tij av. Shëndritë Muriqi, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, dhe përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri, **H.M**, i biri i K. dhe e ëma V., e gjinisë R., i lindur me ..., në B, GJ, ku edhe jeton, por kam edhe vendbanim në R R. e M të Z lagja baza, ka të kryer shkollën e mesme, student, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me dokument GJ ..., boshnjak, shtetas i R. së Gjermanisë.

ESHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më dt. 31.07.2022 rreth orës 00.05 minuta në P, në rrugën regjionale P- P, pikërisht në fsh. Q në mënyrë të drejtpërdrejte iu ka ofruar ryshfet personave zyrtar dhe atë policëve të trafikut Regjional në Pejë A.B dhe D.F dhe atë në mënyrë që pasi policët e lartcekur ia shkruajnë tiketën – fletë paraqitjen kundërvajtëse me nr. vozitës D. M për tejkalim të shpejtësisë i pandehuri H.M ia vendos policit A.B në xhepin e uniformës 30 euro, dhe atë një bankënotë prej 1x20 eurove dhe dy bankënota nga 2x5 euro dhe atë në prezencë të policit D.F me ç’rast i pandehuri arrestohet nga policët e lartcekur .

- Me çka ka kryer veprën penale “Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 7, 17, 38, 39, 40 par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, 42, 43, 44, 69 par.1 pika 3.5, 3.6, 422 par.1 të KPRK-së, nenit 365, 366, 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

Dënim me gjobë në shumë prej 500 € dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

Në kuptim të nenit 44 të KP-së;

Me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar më burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj burgim, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1000 (njëmijë) €,

Konform nenit 76 par. 2 pika 2.4 të KPRK-së, të pandehurin e,

GJYKON:

Me dënim unik me gjobë në shumë prej 1500 € të cilën shumë obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në tërësi, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 € gjobë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse përsëri i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 (njëzetë)€, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Konform nenit 281 par. 1 të KPPRK-së, konfiskohen: 30 euro, dhe atë një bankënotë prej 1x20 eurove nr. serik dhe dy bankënota nga 2x5 euro nr. serik ... dhe, të sekuestruara sipas vërtetimit për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

Të pandehurit i kthehet letër njoftimi nr. ..., lëshuar nga Shteti GJ., meqenëse kanë pushuar shkaqet për të cilat është sekuestruar.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.211/2022 dt. 01.08.2022, kundër të pandehurit H.M, *për shkak të veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.*

Lënda në punë është pranuar me datë 02.08.2022.

Me datë 02.08.2022, është caktuar dhe mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën seancë, bazuar në dispozitën e nenit 244 të KPPRK-së, është konstatuar se Prokurori i Shtetit, i ka përmbushur detyrimet dhe mund të vazhdohet me mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij, të drejta të cilat i ka kuptuar, derisa të drejtën e mbrojtjes e ka shfrytëzuar sipas zgjedhjes së tij.

Pas leximit të aktakuzës, Kryetarja e trupit gjykues, është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e udhëzuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë, konform dispozitës së nenit 248 par.1

të KPPRK-së dhe atë me natyrën e veprës penale e cila ndëshkohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vite, se pranimi duhet të jetë i vullnetshëm, se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, por i mohohet e drejta e paraqitjes së ankesës, për shkaqe tjera pos shkakut për vendim të dënimit.

I pandehuri, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion nga askush.

Kryetarja e trupit gjykues ka marr mendimin nga mbrojtësja e të pandehurit dhe prokurori i Shtetit, të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasur parasysh se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat të cilat i janë bashkangjitur aktit akuzues.

Kryetarja e trupit gjykues, ka aprovuar pranimin e fajësisë e bindur se pranimi i fajësisë është bërë në përmbushje të kushteve ligjore të nenit 248 par.1 pika 1.1 deri 1.4 të KPPRK-së, i cili pranimi i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës siç janë: raportit të policit dt. 31.07.2022, raporti i oficerit policor, dt. 31.07.2022, deklaratës së dëshmitarit D K dt. 31.07.2022, fletë paraqitja për kundërvajtje dt. 31.07.2022, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve nga i pandehuri dt. 31.07.2022 – 1x20 Euro dhe 2x5 Euro, fotot e parave të sekuestruara.

Në bazë të pranimin të plotë të fajësisë të të pandehurit H.M, si dhe në bazë të shkresave tjera të lëndës të cituara më lartë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale *dhënia e rryshfetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-së*.

Konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar me seancën për caktim të dënimit.

Prokurori i Shtetit, me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, i ka propozuar gjykatës që si rrethanë lehtësues për të pandehurin të ketë parasysh sjelljen korrekte të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale, moshën e tij të re, pranimin e tij të fajësisë, pendimin për kryerjen e veprës penale, si dhe faktin se i njëjti më parë ka qenë i pa dënuar dhe është hera e parë që ka rënë në ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese nuk kanë gjet.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Shendritë Muriqi, është pajtuar me fjalën e prokurorit të shtetit, duke shtuar se gjykata të ketë parasysh moshën e re të pandehurit, pendimin e tij, premtimin që në të ardhmë nuk do të bije në ndesh me ligjin, dhe ka kërkuar që të njëjtit të shqiptohet një dënim me kusht ose gjobë.

I pandehuri H.M, e ka përkrah në tërësi fjalën e mbrojtëses së tij, ndihet i penduar.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1 pika 3.5, 3.6 të KP-së, ku si rrethana lehtësuese morri, pranimin e fajësisë, pendimin e thellë, moshën e tij të re, sapo ka mbushur 18 vjet, faktin se asnjëherë më parë nuk është përball me ligjin. Ndërsa si rrethanë rënduese jashtë elementeve të veprës penale, kjo gjykatë nuk gjeti.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par.1 të KP-së,

shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e saj, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesve, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KP-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par 1, lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2, pika 2.6, të KPP- së.

Vendimi lidhur me konfiskimin, është marrë konform nenit 281 par. 1 të KP-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.142/22**

Zyrtare Ligjore
Zelfije Prekaj

Kryetarja e trupit gjykues
Nushe Kuka-Mekaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Pejë e nëpërmjet kësaj Gjykate.